# DËSHMI ARKIVI

**A-477098**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Agron Shehaj në Konferencën Ndërparlamentare me BE: Ju dhe SHBA investuat te drejtësia, Rama i ka shpallur luftë! E sulmon përditë |
| ADRESA | `https://dosja.al/politike/agron-shehaj-ne-konferencen-nderparlamentare-me-be-ju-dhe-shba-investua-i516565` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 17:01:18 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:54:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `dcd8370fa8164726d4aea145b32b15ea2381a103168283deb7e0ed16a0dd5000` |
| TEKSTI | `d60c801e0ce2a2f55f1ceda3129037f8b464206ca1b9b6b55dde7b1227ba63f3` |
| PAMJA | `181fa4a207881b4d568d47ad7528c5d6947d0cb7bf57e62cb2b53c361eb64c5b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c05684f049fec11c9f07c57ac0d21c29d415cba61c1bd9d0ed5c0661082d6e80` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c05684f049fec11c9f07c57ac0d21c29d415cba61c1bd9d0ed5c0661082d6e80`

**PAMJA E FAQES**

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

4 ORE ME PARE
Pagat e magjistratëve/ GJL dhe shoqatat e gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë punën për ligjin e pagave

7 ORE ME PARE
Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder tregon detyrat: Kapitujt duhen mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në baltë, do jetë dështim

8 ORE ME PARE
Përfundon mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, në fokus hetimi ndaj ish-drejtoreshës së SHISH dhe siguria e informacionit të klasifikuar

23 ORE ME PARE
120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

Politike

# Agron Shehaj në Konferencën Ndërparlamentare me BE: Ju dhe SHBA investuat te drejtësia, Rama i ka shpallur luftë! E sulmon përditë

Shehaj tha se shqiptarët e shohin integrimin europian si shpresën për garantimin e të drejtave të tyre dhe theksoi se procesi i anëtarësimit nuk duhet të ndalet.

28 Shtator 2026, 18:54
Nga E. D



Agron Shehaj

**TIRANË-** Kryetari i Partisë Mundësia, Agron Shehaj, ngriti në Konferencën Ndërparlamentare me Bashkimin Europian shqetësimin për atë që e cilësoi si një "luftë të paprecedentë" ndaj drejtësisë në Shqipëri, duke paralajmëruar se po rrezikohet një nga investimet më të rëndësishme të BE-së dhe SHBA-së në vend. Shehaj tha se shqiptarët e shohin integrimin europian si shpresën për garantimin e të drejtave të tyre dhe theksoi se procesi i anëtarësimit nuk duhet të ndalet.

*"Sigurisht shqiptarët duan Bashkimin European. Absolutisht. Nuk e duan vetëm sepse mendojnë që Shqipëria është pjesë e Europës por se e shikojnë si shpresë. Shikojnë dhe mendojnë dhe shpresojnë që ditën që Shqipëria do të jetë pjesë e BE më në fund ata do të kenë të drejta, do t'u njihen të drejtat. Kjo është ëndrra e madhe e shqiptarëve. T'u njihen të drejtat",* deklaroi Shehaj.

Sipas tij, pikërisht në këtë moment rrezikohet një prej investimeve kryesore të partnerëve ndërkombëtarë në Shqipëri: sistemi i ri i drejtësisë.

*"Dhe arsyeja pse për mua ishte shumë e rëndësishme të flisja para jush është sepse nuk do sot po rrezikojmë një nga investimet më të rëndësishme që ka bërë BE me ndihmën dhe të SHBA të bllokohet, të ndalet. Sepse drejtësia nuk është thjesht nën presion. Drejtësisë po i bëhet një luftë e paprecedentë",* tha ai.

Shehaj akuzoi mazhorancën dhe kryeministrin Edi Rama se sulmojnë drejtësinë sa herë që përfaqësues të pushtetit përballen me hetime apo akuza për korrupsion.

*"Kryeministri i Shqipërisë, ju e keni dëgjuar në këto konferenca sesi flet për drejtësinë por ju nuk keni parë anën*

## editoriale

Meri Lika
Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj
Labirinti i errët i Edi Ramës

## Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 16:51
Reforma territoriale/ Këshilli Bashkiak i Belshit voton kundër bashkimit me Elbasanin

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 13:36
VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

*"Kryeministri i Shqipërisë, ju e keni dëgjuar në këto konferenca sesi flet për drejtësinë por ju nuk keni parë anën tjetër të medaljes, se si flet kryeministri i Shqipërisë kur iu flet shqiptarëve, se si i sulmon ata nëpërmjet mediave të tij, në mënyrë të përditshme. Çdo herë që ata nxjerrin para drejtësisë përfaqësuesit e kësaj mazhorance dhe i akuzon për korrupsion Edi Rama del dhe sulmon drejtësinë"*, deklaroi kreu i Mundësisë.

Ai iu referua gjithashtu përplasjes për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke e paraqitur atë si pjesë të presionit ndaj sistemit të drejtësisë.

*"Arriti deri aty sa nuk u pagoi pagat. Sepse Edi Rama mendon që pagat për një prokuror, për një gjyqtar, janë si pagat e tyre, si pagat e politikanëve të korruptuar që kanë qeverisur këtë vend këto 35 vjet. Ata nuk kanë nevojë për paga sepse janë të papërfillshme në krahasim me përfitimet që kanë nga pushteti. Por drejtësia sigurisht nuk është e kulluar. Po aty ka prokurorë dhe gjykatës që me ato paga jetojnë"*, u shpreh Shehaj.

Në fjalën e tij, Shehaj foli edhe për protestat që vijojnë prej më shumë se tre muajsh në Tiranë dhe për problemet që, sipas tij, qytetarët shqiptarë hasin në garantimin e të drejtave themelore.

*"Duhet të kuptoni të nderuar miq të Shqipërisë që Shqipëria fatkeqësisht është vend i padrejtësive. Dhe ashtu si unë si kryetari i një partie opozitare duhet të luftoj për fjalën e lirë për të bërë opozitë, ashtu çdo qytetar shqiptar lufton çdo ditë për të drejtat themelore që ju as nuk mund ta imagjinoni"*, tha ai.

Shehaj e mbylli fjalën duke falënderuar përfaqësuesit europianë për mbështetjen ndaj procesit të integrimit të Shqipërisë.

*"Ju falënderoj që jeni këtu dhe që vazhdoni dhe besoni pavarësisht problemeve, që Shqipëria duhet të jetë pjesë e BE," tha Shehaj./***Dosja.al**

agron shehaj

## Sondazh

Poll

Politike

28 Shtator 2026, 18:29

# "A-ja e gjithçkaje është afërsia me qytetarin"/ Fisnik Qosja në Komisionin e Ligjeve: Kërkojmë vlerësim publik të reformës së kaluar para se të merret vendimi përfundimtar

Fisnik Qosja TIRANA- Fisnik Qosja, kryetari i Bashkisë së Kavajës ka marrë fjalën në Komisionin e Ligjeve ku ka mbështe...

FOTOLAJM/ Elvis Lila u shfaq për herë të parë në publik, kush është drejtuesi i ri i SHISH i komanduar nga Rama

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 13:01

FOTOLAJM/ Kush janë dy të rinjtë që tentuan të mashtronin Armand Dukën dhe lidhja me Florian Gjergjin

## më të klikuarat

Hakerat iranianë nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

WSJ zbardh prapaskenat: Ja si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 mld $ në Shqipëri

## insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

## Moti

Powered by tomorrow.io

Politike

28 Shtator 2026, 17:51

---

**Debate te "Ligjet" për territorialen/ Brahimi: Bashkimi i bashkive ul kostot me mbi 30%. Korreshi: Ky po tall by***n, po e bëni për të grumbulluar votat e PS**

Politike

28 Shtator 2026, 17:34

---

**Rama takim me drejtuesit politikë në qarqe te “Vila e Kuqe”/ Në fokus “Prania besnike” dhe takimet me qytetarët**

Politike

28 Shtator 2026, 16:41

---

**Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidate**

Politike

28 Shtator 2026, 15:42

---

Politike

28 Shtator 2026, 15:06

# Bardhi takon Ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Krimi dhe korrupsioni kanë kapur shtetin

Gazment Bardhi TIRANË- Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi ka zhvilluar një takim me ambasadoren e Mbretërisë...

---

**Veliaj propozon shpërblim për zjarrfikësit pas betejës me flakët, vendimi pritet të miratohet në Këshillin Bashkiak**

Politike

28 Shtator 2026, 15:01

### PD: Edi Rama bëri sot akt shantazhi politik në zemër të Europës, foli për fëmijët e Ursula von der Leyen, në vend që të fliste për fëmijët e Shqipërisë

Politike

28 Shtator 2026, 14:36

### Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Kuvendi i Kosovës miraton DEKLARATËN kundër vendimit: I papranueshëm, drejtësia për viktimat dhe familjet e tyre

Politike

28 Shtator 2026, 14:08

### VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Politike

28 Shtator 2026, 13:36

MË SHUMË





Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve


Tentuan të mashtronin Armand Dukën në emër të Taulant Ballës, në pranga sekserët e Florian Gjergjit


Debati ironik në Komision, Korreshi: Të ndryshohet rendi i ditës i nderuar kryetar


Mashtruan një të moshuar në emër të Armand Dukës, në pranga 2 sekserët e Florian Gjergjit...

## Protesta në Maliq kundër investimit të Ujësjellësit/ Përplasje mes efektivëve dhe qytetarëve

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]



Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

MUNDESUAR NGA Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.